



01/Nr. 5971 /2021

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 11, 12, 40, Ligjit Nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, neni 3, paragrafi 1.32, 1.43, neni 17 paragrafi 1, Ligjit Nr. 03L/-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 30, paragrafi 1, Ligji Nr.08/L-016 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 07/L-041 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021. Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datën 31.08.2021 merr:

**VENDIM
PËR RIALOKIM DHE TRANSFER TË MJETEVE NË KATEGORITË EKONOMIKE TË
SHPENZIMEVE**

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për rialokim dhe transfer të mjeteve në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale.
2. Rialokimi i dhe transferi i mjeteve në kategorinë shpenzime kapitale është në shumë prej 80,068.00 €, pastaj transferi i mjeteve në kategorinë paga dhe shtesa është në shumë prej 14,000.00 €, ndërsa transferi i mjeteve nga kategoria shpenzime komunale në atë mallra dhe shërbime është në shumë prej 1,900.00 €. Pra, rialokimi dhe transferi i mjeteve në total për komunën e Hanit të Elezit është në shumë prej 95,968.00 € nga fondet 10 dhe 21 sipas programeve/nën-programeve buxhetore.
3. Pjesë e këtij vendimi janë tabelat 4.1 Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2021 (Ndryshimet) dhe 4.2 Financimi i investimeve kapitale për vitin 2021 (rialokimi dhe transferi i mjeteve) dhe kërkesat për transfer/alokim.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorët e Drejtorive Komunale,
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

**Data : 31.08.2021
Hani i Elezit**

